**20262093308**

## СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

## L I GJ
## PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT TË REZERVAVE TË DETYRUESHME TË NAFTËS

Neni 1

Në Ligjin për rezervat e detyrueshme të naftës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 144/14, 178/14, 199/15, 197/17 dhe 7/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ numër 275/19, 150/21, 236/22 dhe 147/24), neni 25 ndryshohet si vijon:

„(1) Me punën e Agjencisë për rezerva të detyrueshme udhëheq drejtori të cilin e emëron dhe e shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të ministrit të Energjetikës, Minierave dhe Burimeve Minerale.

(2) Për drejtor mund të emërohet personi që plotëson kushtet për emërim të drejtorit të përcaktuara me Ligjin për drejtuesit e lartë.

(3) Për emërimin e drejtorit zhvillohet procedurë e emërimit në përputhje me Ligjin për drejtuesit e lartë.

(4) Mandati i drejtorit zgjat pesë vjet.

(5) Drejtori për punën e Agjencisë për rezerva të naftës dorëzon raport gjashtëmujor dhe vjetor te ministri i Energjetikës, Minierave dhe Burimeve Minerale. Raporti gjashtëmujor dorëzohet më vonë deri më 30 korrik të vitit krent, ndërsa raporti vjetor deri më 31 mars të vitit korent për vitin paraprak.

(6) Drejtorit mandati i pushon me kalimin e mandatit, ndërsa para kalimit të mandatit shkarkohet dhe mandati i pushon sipas fuqisë ligjore në përputhje me Ligjin për drejtuesit e lartë.“.

Neni 2

Neni 53 shlyhet.

Neni 3

Drejtori i emëruar deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji vazhdon të kryejë funksionin deri në kalimin e mandatit për të cilin është emëruar.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga botimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, kurse do të fillojë të zbatohet nga 1 tetori i vitit 2026.